



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 57 Prot.

Tiranë, më datë 07.02.2019

VENDIM

Nr. 42, datë 07.02.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RESTAURIMIT

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2 dhe neni 72, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 07.02.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e Projektit: “Restaurimi i banesës së Vladimir Ponde në Gjirokastrë”, hartuar nga Ark. Jorgo Xuhano;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1;
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI

SEKRETARI KKR

Arta Dollani

